

Akt Themelimi

I shoqërisë tregtare "M.B.B TECHNOLOGY" SH.P.K.

Mbeshtetur në Kushtetuten dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, në mënyrë të lirë dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit", të ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Për shoqëritë tregtare" dhe të ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Për Q.K.R dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tyre të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, në ortakët z. Remo Mantovani, me nr. ID AX2842454, z. Davide Berretta me nr. ID AR8300319 dhe z. Antonio Berretta me nr. ID CA24379FF, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "M.B.B TECHNOLOGY" SH.P.K. me akt themelimi si vijon :

Formulimi
Neni 1

Sot me date 11.11.2019, formohet shoqëria tregtare private e quajtur "M.B.B TECHNOLOGY" SH.P.K. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar, ndërsa deget që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë degë. Shoqëria do të ushtroje veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

Selia e Shoqërisë
Neni 2

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Në Kavajë, Lagja nr.2, Bulevardi Josif Budo, e ndodhur në zonë kadastrale nr.8551, pasuria me numer 4/368-N16. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblese dhe ortakeve të saj.

Objektivi i Veprimtarisë
Neni 3

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:
Import-Eksport artikuj industrial dhe ushqimorë, artikuj teknologjike dhe inovative në sektorin energjetik dhe kursimit energjik. Klimatizim me ajër të kondicionuar, sistem ngrohje dhe ftohje për shtëpi dhe për industri. Prodhim dhe instalim të impianteve të kogjenerimit të prodhimit të energjisë elektrike, me anë të energjive të rinovueshme, artikuj teknologjike për kursimin e energjisë së lartë dhe ndricimit. Konsulte teknike mbi kursimin e energjisë, ndricimin elektrik, si dhe sistemin e ngrohjes dhe ftohjes.


Kohe zgjatja e Shoqërisë
Neni 4

Kohe zgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

Kapitali i Shoqërisë
Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 lekë (njëqind mijë) Lekë.

1. Ortaku themelues Z.Remo Mantovani: Zoterues i 1(një) kuote me vlerë të përgjithshme 33.000 (tridhjetë e tre mijë leke) që përben 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.



2. Ortaku themelues Z. Davide Berretta: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 34.000 (tridhjetë e kater mijë leke) që përben 34% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Ortaku themelues Z. Antonio Berretta: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 33.000 (tridhjetë e tre mijë leke) që përben 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Drejtimi i Shoqerise

Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj z.Davide Berretta, i cili do te jete dhe perfaqesuesi ligjor i saj. Ai eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posaçme.

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut.

Neni 8

Ortaku ka te drejte te emeroje dhe administratore te tjere te vlerave materiale.

Ka te drejte te caktojë financiere, likuidator per problemet e shoqerise si dhe te pajtojë persona te tjere si ortake.

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Kavaje.

Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin rreth saj.

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri .

Neni 12

Akti i themelimit u perpilua ne 2 kopje, per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "M.B.B TECHNOLOGY" SH.P.K.

Akti i themelimit nenshkruset rregullisht nga ortaku.

Ortakët themelues:

Remo Mantovani

Davide Berretta

Antonio Berretta

